

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Numri i lëndës: P. Kr. Nr. 282/2014; PPS 45/2012

Data: 4 shkurt 2015

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS në Trupin Gjykses të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it **Jennifer Seel**, Kryetare e trupit gjykses, Gjyqtarja e Republikës së Kosovës **Valbona M.-Selimaj**, dhe Gjyqtarja e EULEX-it **Marie Tuma**, anëtarë të trupit gjykses, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjor të EULEX-it David Hegarty, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër:

1. B.D.

Emri dhe mbiemri:	B.D.
Emri i babait:	S.
Profesioni:	Bujk
Data e lindjes :	Xx xx xxxxx
Vendi i lindjes:	xxxx, Komuna e Drenasit
Vendbanimi:	Rruga xxxxxxxx, xxxxx
Kombësia dhe shtetësia:	Shqiptar nga Kosova
Numri i letërnjoftimit:	xxxxxxx
Statusi familjar:	I martuar; katër fëmijë

1. H.T.

Emri dhe mbiemri:	H.T.
Emri i babait:	B.
Profesioni:	I papunë
Data e lindjes :	Xx xx xxxx
Vendi i lindjes:	xxxxx, Komuna e Skenderajt
Vendbanimi:	Rruga xxxxxxx, në Prishtinë, kati i xxxx hyrja xx
Kombësia dhe shtetësia:	Shqiptar nga Kosova

Numri i letërnjoftimit:	xxxxxxx
Statusi familjar:	I martuar; dy fëmijë

Të dy të akuzuar nën Aktakuzën e Prokurorit Publik P Kr. Nr. 282/14, të datës 19 maj 2014 dhe të ngritur në Shkrimoren e Gjykatës Themelore të Prishtinës më 21 Maj 2014 për veprën penale:

1. USHTRIMI I NDIKIMIT duke kërkuar, marrë ose pranuar një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të paduhur nga ana e kryerësit mbi vendimmarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar, në shkelje të nenit 345, paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (2004) (në tekstin e mëtejshëm si "KPPK"), dhe i dënueshëm me gjobë ose me burgim deri në dy (2) vjet;

Dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor , të hapur për publikun, më 29 deri më 30 tetor 2014 , 04, 11, 12, 25 dhe 26 nëntor 2014, 17 dhjetor 2014, 20 dhe 21 janar 2015 dhe 2 shkurt 2015 dhe me aktgjykimin e shpallur më 4 shkurt 2015; të gjitha në prani të të pandehurve B.D. dhe H.T.; dhe kur u kërkuar nga të pandehurit, në prani të avokatëve të tyre përkatës, avokatët mbrojtës B.T. dhe M.H. apo zëvendësuesit e tyre; dhe Prokurori i EULEX-it, Andrew Carney, pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur më 2 shkurt 2015, në bazë të nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm si "KPP"), e shpallur publikisht dhe në prani të të pandehurve, Avokatëve të tyre mbrojtës, si dhe Prokurori Publik Andrew Carney, nxjerr këtë: -

AKTGJYKIM

I. Të akuzuarit, **B.D.** dhe **H.T.**, me të dhënat personale të cituara më sipër,
shpallen

FAJTORË

Lidhur me Akuzën nr. 1 të Aktakuzës

Për shkak se është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se në periudhën kohore midis prillit 2009 dhe qershorit 2009, dy të pandehurit kërkuar dhe morën një shumë prej 200,000 eurove nga një grup prej pesë individëve në lidhje me ushtrimin e ndikimit mbi vendimmarrjen

e zyrtarëve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme "AKP") në lidhje me një ofertë të paraqitur në një tender të privatizimit.

Duke rrjedhur nga shpallja e Valës së 34 të Privatizimit nga AKP-ja më 14 prill 2009, 5 individët e lartpërmendur, domethënë Sh.Z., Z.B., I.M., B.K. dhe A.J. u morën vesh për të blerë 91 hektarë tokë në fshatin M. në Komunën e Obiliqit. Para se të parashtronin ofertën për tenderin për blerjen e tokës, të pandehurit dhe të paktën katër prej anëtarëve të grupit, pra S.Z. Z.B., I.M. dhe B.K., lidhën një marrëveshje, ku të pandehurit do të ushtronin ndikimin e tyre në AKP, për të siguruar që oferta për blerjen e tokës në emër të B.K.t do të ketë sukses. Shpërblimi për këtë marrëveshje ishte një pagesë prej të paktën 200, 000 Euro para të gatshme që do t'iu jepeshin të pandehurve.

Më 20 maj 2009 B.K. paraqiti një ofertë në shumën e një milion e gjysmë euro për 91 hektarë tokë të përmendur më lart. Kjo ofertë ishte e suksesshme. Shpërblimi, për të cilën ishin marrë vesh, iu pagua të pandehurve sipas kërkesës së tyre. Të pandehurit, në përputhje me këtë, e morën shumën prej 200, 000 eurove në dy këste. Kësti i parë prej të paktën 120,000 eurove në para të gatshme iu ishte dorëzuar të pandehurve nga S.Z. dhe Z.B. gjatë një takimi në Restorant Druri në fund të majit 2009. Kësti i dytë iu ishte paguar rreth një javë më vonë.

Në këtë mënyrë, të pandehurit B.D. dhe H.T., me të dhënat personale të sipër përmendura, kanë kryer veprën penale të **USHTRIMIT TË NDIKIMIT** në bashkëkryerje në kundërshtim me nenin 345, paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPPK.

II. I pandehuri **B.D.**:

DËNOHET

Me një (1) vit dhe tre (3) muaj burgim për Pikën 1 - Ushtrimi i ndikimit ;

I pandehuri **H.T.**:

DËNOHET

me një (1) vit dhe tre (3) muaj burgim për Pikën 1 - Ushtrimi i ndikimit.

III. Të pandehurit **B.D. dhe H.T.**, detyrohen që bashkërisht dhe individualisht të paguajnë një shumë prej dyqind mijë Euro (€ 200,000) si kompensim për konfiskimin e shpërblimit të dyqind mijë Eurove (€ 200,000) të fituara përmes kryerjes së veprës penale.

Të pandehurit lejohen për ta paguar këtë shumë në 20 këste mujore prej dhjetë mijë Eurove(€ 10.000).

IV. Secili nga të pandehurit do të paguajë shumën prej njëqind e pesëdhjetë euro (€ 150), si kompenzim për pjesën e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa do të jenë të liruar nga detyrimi i kompenzimit të bilancit të shpenzimeve të procedurës, në bazë të nenit 453, paragrafët 1, 3 dhe 4 të KPPK-së.

ARSYETIMI

A. KOMPETENCAT E TRUPIT GJYKUES

1. Në bazë të nenit 11 (1) të Ligjit për Gjykatat, Ligji Nr. 03 / L-199, Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha rastet, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe. Neni 9 (2,1) të Ligjit mbi Gjykatat thekson se Gjykata Themelore e Prishtinës është themeluar për territorin, ndër të tjera, Komunën e Prishtinës. Sipas nenit 15 (1,19) të Ligjit të njëjtë, vepra penale e Ushtrimit të ndikimit bie në juridiksionin e Drejtorisë së Krimeve të Rënda, dhe sipas paragrafit (2), do të shqyrtohet nga një trup gjykues prej tre (3) gjyqtarëve profesionistë , me një (1) gjyqtar të caktuar për të kryesuar trupin gjykues.

2. Në bazë të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve e gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në lidhje me Memorandumin e Mirëkuptimit, rastet në të cilat aktakuza ishte ngritur pas 15 prillit 2014 duhet të gjykohen nga gjyqtarët e EULEX-it në bazë të një vendimi përkatës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Më 29 qershor 2014 kërkesa përkatëse iu ishte dërguar KGJK-së, dhe me 2 korrik 2014 u konfirmua se rasti duhet të gjykohet me një shumicë të gjyqtarëve të EULEX-it, duke përfshirë Kryetarin e trupit gjykues nga radhët e EULEX-it. Ky vendim u vulos me vulën e kaltër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në vendimin e tyre nr. 01/96 më 2 korrik 2014 dhe ky rast është i treti nga katër rastet e përfshira në atë vendim.

B. HISTORIA PROCEDURALE

3. Më 01.08.11, Prokurori i PSRK- së Ali Rexha, lëshoi një Aktvendim për fillimin e hetimeve kundër të pesë (5) të pandehurve, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të krimit të

organizuar, pastrimit të parave, dhënia e ryshfetit, dhe pranimi i ryshfetit. Më 31.01.12 Gjyqtari i procedurës paraprake i vazhdoi hetimet për këto akuza edhe për 6 muaj të tjerë, deri më 01.08.12, sipas numrit të lëndës PPS 48/2011.

4. Më 21.05.12, Prokurori i PSRK-së Ali Rexha lëshoi një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve në lidhje me shtatë të pandehur të tjerë, duke përfshirë dy të pandehurit këtu B.D., H.T., dhe pesë (5) të tjerë, të dyshuar për kryerjen e veprave penale të Pranimi të ryshfetit, Dhënies së ryshfetit, Ushtrimi i ndikimit dhe Shpërdorim të pozitës zyrtare ose autoritetit.

5. Më 23.05.12, Prokurori i PSRK-së, Ali Rexha lëshoi një Aktvendim duke i bashkuar të dyja rastet sipas numrit PPS 45/12 dhe më 18. 12. 2012 Gjyqtari i procedurës paraprake i vazhdoi hetimet deri më 21. 05. 2013.

6. Më 04.04.13, Prokurori i PSRK të EULEX-it, Andrew Carney lëshoi një Aktvendim mbi zgjerimin e akuzave të hetimeve kundër të pandehurve, dhe më tej, më 20.05.13 lëshoi një Aktvendim tjetër për zgjerimin e hetimeve në lidhje me akuzat për armë kundër pesë të pandehurve.

7. Më 16. 07. 2013 Prokurori i PSRK-së, Prokurori i EULEX-it e paraqiti një kërkesë për vazhdimin e hetimeve të bashkuara dhe të zgjeruara, të cilat kishin nisur më 01.08.11.

8. Më 26. 04. 2013 dhe 11. 02. 2014, hetimet ishin ndërprerë ndaj një numri të të pandehurve, dhe, në Aktvendimit e fundit, kundër të pandehurit H.T. në lidhje me akuzat për armë.

9. Më 21 maj 2014 prokurori i PSRK-së, Andrew Carney ngriti aktakuzë në rastin PKR 282/14 kundër të pandehurve këtu të datës 19 maj 2014, e cila i akuzonte të pandehurit, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

10. Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 29 deri më 30 tetor 2014, 04, 11, 12, 25 dhe 26 nëntor 2014, 17 dhjetor 2014, 20 dhe 21 janar 2015 dhe 2 shkurt 2015 dhe me aktgjykimin e shpallur më 4 shkurt 2015.

C. PROVAT E PRANUESHME

1. Të dy të pandehurit e shfrytëzuan të drejtën e tyre për të heshtur gjatë tërë procedurës. Prandaj, faktet e vërtetuara në aktgjykim janë bazuar në të gjitha provat e pranueshme pas rrjedhës së shqyrtimit kryesor:

I. Dëshmitarët

2. Gjatë gjyqimit, dëshmitarët e shënuar më poshtë dhanë deklarata (të referuara më poshtë në bazë të paraqitjes së tyre në gjyq): -

- a. Sh.Z.
- b. Z.B.
- c. I.M.
- d. A.J.
- e. H.K.
- f. B.K.

II. Dëshmitë e dokumentuara dhe protokollet e përgjimit

3. Në seancën e shqyrtimit kryesor më 15 janar 2015 palët ranë dakord që përmbajtja e dëshmive nga shkresat e lëndës të konsiderohen si të lexuara. Gjykata i konsideron provat e dokumentuara, që gjenden në Lidhjen 1 dhe protokollet e përgjimit të ligjshëm të komunikimit telefonik, të cilat gjenden në Lidhjen 3, si dëshmi të pranueshme. Megjithatë, theksohet se të gjitha dokumentet dhe protokollet e përgjimit, në bazë të të cilave është i bazuar aktgjykimi u lexuan gjatë procedurës¹.

III. Video klipi

4. Gjatë shqyrtimit kryesor u prezantua një video klip² privat, i cili ishte regjistruar nga dëshmitari A.J.me telefonin e tij. Ky video klip është i gjatë 5:45 dhe sipas dosjeve të policisë ajo ishte incizuar në maj të vitit 2009. Videoja ishte dorëzuar në polici nga dëshmitari.

IV. Të dhënat financiare

5. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u kontrolluan të dhënat financiare të llogarisë financiare nga llogaria bankare e dëshmitarit B.K.në Bankën NLB³, të cilat ishin marrë në bazë të urdhrin për zbulimin e të dhënave financiare të datës 10 janar 2012.

V. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor u paraqit ky mocion:

6. Në seancën e datës 30 tetor 2014, trupi gjykues vendosi për pranueshmërinë e përgjithshme të deklaratave të mëparshme, që dëshmitarët i kishin dhënë në cilësinë e të pandehurve. Trupi gjykues vendosi që këto deklarata nuk do të mund të përdoren si dëshmi të drejtpërdrejta, por

²Shih transkriptin e videos në Dosjen 3, faqe 206.

³Shih Lidhjen 1, faqet 223

në mënyrë indirekte si prova materiale gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit, për të rifreskuar kujtesën e dëshmitarit apo për të sfiduar dëshmitarin gjatë kryerjes së ekzaminimit të tërthortë apo rimarrjes në pyetje⁴.

7. Trupi gjykues konkludon se këto deklarata duhet të trajtohen si deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve, në pajtim me nenin 123 KPP, sepse është e parëndësishme nëse ato ishin dhënë si deklarata të të pandehurit apo si deklarata të të dyshuarit⁵. Trupi gjykues është në dijeni se në një situatë të kundërt, ku të pandehurit kishin dhënë deklarata të mëparshme si dëshmitarë, këto deklarata nuk mund të përdoren për të sfiduar të pandehurin. Një procedurë e tillë do të shkelte të drejtat e të pandehurve për gjykim të drejtë, duke anashkaluar të drejtat e tyre gjatë shqyrtimit të procedurës paraprake. Rasti në fjalë është i ndryshëm. Në shembullin në fjalë, dëshmitari ka vetëm të drejtën për të mos e fajësuar veten. Kjo e drejtë është respektuar, sepse procedura kundër dëshmitarëve ishte ndërprerë tashmë për shkak të parashkrimit të lëndës. Në këtë rast të drejtat e të pandehurit nuk janë prekur, sepse ajo mbetet detyrim i trupit gjykues për të vlerësuar cilësinë e deklaratës. Kur të vlerësohet besueshmëria e dëshmitarit, do të merret në konsideratë fakti se deklaratat e mëparshme janë dhënë në cilësinë e të pandehurit.

8. Megjithatë, Gjykata vëren se në këtë rast përgjigjet që dëshmitarët i dhanë kur u përballën me deklaratat e tyre të mëparshme nuk janë marrë fare në konsideratë, sepse trupi gjykues i klasifikoi ato në të gjitha rastet si jo të frytshme megjithatë.

D. GJETJET FAKTIKE

9. Pas fazës së provave të shqyrtimit gjyqësor, në bazë të provave të pranueshme të paraqitura dhe të administruara, Gjykata konstaton faktet e mëposhtme relevante si të vërtetuara përtej dyshimit të arsyeshëm:

1. Faktet e konsideruara si të vërtetuara

10. Në prill 2009 Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) shpalli valën e 34 të privatizimit, i cili përfshinte 91 ha të ish-tokës bujqësore në rajonin Musakaj, të cilat duhej t'i transferoheshin një

⁴Në këtë drejtim trupi gjykues vendosi se të drejtat e përshkruara në nenin 123 KPP për ekzaminimin e tërthortë janë të zbatueshme edhe gjatë ri-marrjes në pyetje të dëshmitarit, gjithashtu; përndryshe nuk do të kishte asnjë mënyrë për të sfiduar kredibilitetin e dëshmitarit për palën që e prezantoi dëshmitarin. Kjo nuk do të kishte lidhje logjike me qëllimin e përgjithshëm të procedurës për të gjetur drejtësi dhe të vërtetën.

⁵ Sa i përket Avokati i Mbrojtjes që theksoi se shumica e intervistave janë kryer pa praninë e avokatëve, ajo është e shënuar - se edhe në rast të krimeve të rënda në atë fazë shumë të hershme të procedurës në pajtim me nenin 58 KPP prania e një avokati nuk ishte e detyrueshme.

kompanie të re filiale Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Musaka LLC⁶. Dëshmitari I.M. kishte dëgjuar për tenderin dhe kishte vendosur për të marrë pjesë. Ideja e tij ishte për ta blerë tokën dhe të fitonte nga shitja e parcelave të saj. M. kishte kontaktuar me dëshmitarin Z.B., një mik i vjetër, dhe të dy vendosën të paraqitnin një ofertë për atë vend. B. ia prezantoi I. dëshmitarët Sh.Z. dhe B.K., sepse ata vlerësuan se do të duhej një grup më i madh i njerëzve për të drejtuar projektin, për të ngritur investimet e nevojshme dhe për të gjetur blerës për tokën. Pasi që ata nuk kishin mundësi financiare për të paguar taksat e regjistrimit, K. ia prezantoi grupit mikun e tij A.J., dhe ai u bë një anëtar i grupit, me detyrë konkrete për të paguar tarifën e regjistrimit. U vendos që oferta duhej të dorëzohej në emër të B.K.t, i cili doli të jetë i vetmi që ishte në gjendje për të marrë vërtetimin e nevojshëm nga gjyqi që ai nuk ishte nën hetime. Shumica e shkresave ishin bërë nga S.Z..

11. Gjatë kësaj kohe grupi kuptoi se ata nuk do të jenë në gjendje për të fituar tenderin në mënyrë ligjore. SH.Z. e diskutoi këtë çështje me të njohurin e tij B.D., i cili e siguroi atë se ai do të jetë në gjendje për t'i ndihmuar atij në këtë drejtim. D. gjithashtu tha se ai kishte një mik, i cili mund të ndihmonte. Pas kësaj dëshmitarët Z. dhe B. u takuan me D. në Momento Restaurant në Prishtinë, dhe D. i njoftoi ata me të pandehurin Th.. Në këtë takim dhe pas kësaj të dy palët u pajtuan se të pandehurit do të gjenin njerëz, që do të siguronin që oferta e grupit të ishte e suksesshme, dhe për këtë grupi do të paguante 200,000 euro. Ndërsa këto negociata kryesisht u bënë nga Z., dëshmitarët B. dhe M. ishin të paktën pjesërisht të pranishëm.

12. Para se të paraqitej oferta, u arrit një marrëveshje ndërmjet dy të pandehurve dhe të paktën katër anëtarëve të grupit, domethënë S.Z.t, Z.B., I.M.t dhe B.K.t. Më 20 maj 2009 dëshmitari B.K. në emër të të gjithë grupit paraqiti një ofertë. Edhe pse të pandehurit e kishin këshilluar Z.n që të ofertonte në shumën prej 2.300.000 euro, ai konsideroi se kjo ishte tepër shumë për të konkurruar dhe ai konkurroi me vetëm 1.500.000 Euro.

13. Më 26 maj 2009 B.K. u njoftua me shkrim se oferta e tij ishte përzgjedhur si oferta fituese. Pas kësaj, të pandehurit iu afruan grupit dhe kërkuan shpërblimin, për të cilin kishin rënë dakord. Pasi që asnjëri prej anëtarëve nuk i kishte paratë, grupi hasi në vështirësi për të kryer detyrimin e tyre ndaj të pandehurve menjëherë. Anëtarët e grupit kuptuan se mjeti i vetëm për ngritjen e fondeve menjëherë ishte të gjenin blerës për tokën që e kishin fituar, të cilët do të ishin të gatshëm për të paguar në këtë fazë të hershme.

14. Menjëherë pasi B.K. ia shiti 10 ha tokë një të afërmi të tij, B., i cili është pronar i Kompanisë Ushqimore Jugobella / Kosmonte. Formalisht blerja u realizua në formën e një kredie të dhënë nga K., dhe një kontratë e para-shitjes. Menjëherë pas kësaj, B.K. mori një shumë prej të paktën

⁶Për detaje të mëtejshme shih Lidhja1, faqe 1 deri në 62. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 dhe 2003/13 të drejtat pronësore do të transferohen në formën e një qiraje 99 vjeçare.

124,000 euro në të gatshme, ndërsa disa këste të tjera u paguan në javët në vijim në llogarinë bankare të B.K.t.

15. Kjo pagesë në para të gatshme ishte sjellë në shtëpinë e Z.B. dhe bankënotat ishin numëruar nga të gjithë anëtarët e grupit në një ditë të paspecifikuar në maj të vitit 2009. Pas numërimit, paratë u futën në një qese plastike të errët dhe dëshmitarët B. dhe Z. (ndoshta të shoqëruar nga një anëtar i tretë i grupit) u takuan me të pandehurit në një Restorant të quajtur Druri në Prishtinë. Ata ia dorëzuan një shumë prej të paktën 120,000 euro në bankënota, që ata i sollën në një qese plastike të errët. Të pandehurit vunë në dukje se kjo nuk ishte shuma e rënë dakord dhe kërkuan pjesën tjetër të shumës. Rreth një javë më vonë një këst i dytë i ishte paguar të pandehurve, kështu që u pagua shuma e përgjithshme e rënë dakord prej 200,000 Euro.

16. Pas kësaj, të pandehurit apo personat pas tyre, kërkuan kompensim të mëtejshëm, dhe në të njëjtën kohë për arsye të ndryshme grupi filloi të thyhej. A.J. i pari kishte vendosur të tërhiqej, dhe menjëherë më vonë ishte kompensuar për investimet e tij dhe e la grupin. Në shtator 2009 në rrethana të panjohura dëshmitarët Z. dhe B. ranë dakord të tërhiqen nga grupi në këmbim të kompensimit, dhe të pandehurit u bënë aksionarë të rinj të projektit.

17. Që nga shtatori 2009 dëshmitari K., i cili e njihte B.K. n, si dhe të pandehurin B.D. për shumë vite, ishte i përfshirë në projekt. Në periudhën rreth tetorit 2009 I.M. gjithashtu e tërhoqi pjesëmarrjen e tij, dhe ai u zëvendësua nga K. si aksionar i katërt i projektit. Më në fund, më 5 tetor 2009, dy të pandehurit dhe dëshmitarët B.K. dhe H. bënë një marrëveshje të brendshme për të qenë aksionarë të barabartë në projektin e tokës. Gjersa dëshmitari K. ka paguar 134,000 euro për t'u bërë një partner, të pandehurit lidhën kontratën pa obligim për të kontribuar financiarisht. Prandaj besohet, se partneriteti i tyre ishte një kompensim për ushtrimin e mëparshëm të ndikimit, dhe gjithashtu një mjet për të siguruar ndikimin e tyre të mëtejshëm mbi institucionet, pasi që procesi ende nuk kishte përfunduar.

18. Në ndërkohë, dëshmitari K. i përmbushi kërkesat për parat që ia kishte borxh AKP-së, dhe në përputhje me këtë ai e pagoi shumën totale të 1.500.000 Euro në katër këste nga llogaria e tij bankare. Mjetet e nevojshme për këto pagesa u fituan nga shitjet tjera të vendit përkatës.

19. Edhe pasi të gjitha këstet ishin paguar, punonjësit përgjegjës në AKP ngurronin ta finalizonin kontratën e tokës, sepse më 16 qershor 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë shqiptoi një masë të përkohshme në një pjesë të tokës⁷. AKP-ja ngriti ankesë ndaj këtij vendimi, por pasi që nuk kishte asnjë vendim deri në mars 2009, punëdhënësit në departamentin ligjor dhe atë të shitjes

⁷ Për hollësi, shih Memorandumin e AKP-së në Lidhjen 1, faqet 145 - 150

së AKP-së diskutuan se si të vazhdohet⁸. Gjatë kësaj kohe të pandehurit kanë pasur kontakt me zyrtarët e AKP-së. Pavarësisht nga çështjet e pazgjidhura ligjore, më 27 prill 2010 u finalizua kontrata dhe Ndërmarrja e Re Tokë Bujqësore Musakaj LLC iu transferua B.K.t.

II. Faktet të konsideruara si të pa vërtetuara

20. Pas fazës provuese të shqyrtimit gjyqësor faktet e mëposhtme nuk janë vërtetuar:

21. Nuk mund të vërtetohet se çfarë lloj të ndikimit të pandehurit kanë ofruar për të ushtruar, dhe në kënd pikërisht ata do të ushtronin ndikim. Edhe pse është mjaft e mundshme që i pandehuri ka ushtruar ndikim, ajo ka mbetur e pa vërtetuar, si dhe, deri në çfarë mase ky ndikim eventual ishte vendimtar në procesin e vendim-marrjes së punonjësve përgjegjës të AKP-së.

22. Ndonëse Paneli konstatoi se u provua përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se palët ranë dakord mbi një avantazh të padrejtë prej 200,000 Euro që duhej paguar të pandehurve, mbeti e paqartë se deri në çfarë mase ishte rënë dakord për një kompensim të mëtejshëm. Sipas disa dokumenteve, duket se të pandehurit do të shpërbleheshin me një tjetër shumë prej 100,000 Eurove ose me një parcelë të tokës përkatëse. Pasi që informatat në lidhje me këtë kompensim ndryshojnë, është më e mundshme që marrëveshja ishte ende nën negociatë, dhe se kompensimi i rënë dakord varej në kohën e saktë dhe në njerëzit e përfshirë. Trupi gjyqësor konkludoi se çfarëdo kompensim i premtuar përtej 200,000 Eurove mbeti i paqartë dhe nuk mundi të provohej përtej dyshimit të arsyeshëm.

23. Në mënyrë të ngjashme, Trupi gjyqësor nuk ishte i bindur se të pandehurit morën një sasi që tejkalon 200,000 Euro. Ndërsa është e padiskutueshme se të pandehurit kanë përfituar nga angazhimi i tyre në rrjedhën e mëvonshme të procedurës, kjo nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se ky kompensim nuk ishte i lidhur me aktivitetet ligjore të kryera nga të pandehurit, dhe atë kërkimi për blerësit e tokës, apo në ushtrimin e ndikimit shtesë më vonë.

24. Më tutje, ka mbetur e paqartë nëse dëshmitari A.J. ishte pjesë e marrëveshjes në mes të grupit të dëshmitarëve dhe të pandehurve apo nëse ai ishte i vetëdijshëm se një marrëveshje e tillë ka ekzistuar para se të dërgohet oferta. Ngjashëm, përfshirja e dëshmitarit H.K. para se ai të bëhej anëtar i grupit të projektit në tetor 2009 mbetet e paqartë.

E. ANALIZA E PROVAVE

25. Gjetjet faktike janë bazuar në të gjitha provat e pranueshme, siç janë paraqitur më lartë. Trupi

⁸ Fillimisht ishte planifikuar të ndërpritej seanca gjyqësore dhe t'i paguheshin fondet e depozituara dëshmitarit K.. Ai ishte i informuar për këtë shkrim më 16 mars 2010, shih Lidhjen 1, faqe 151-152.

gjkues ka shqyrtuar dëshminë e gjashtë dëshmitarëve, si dhe provat e dokumentuara, të dhënat financiare, videot e lartshënuara dhe rezultatet e përgjimeve të ligjshme për të përcaktuar faktet.

I. Analiza e dëshmive të dëshmitarëve

26. Pas intervistimit të dëshmitarëve të lartshënuar gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues ka vlerësuar besueshmërinë dhe kualitetin e deklaratave si në vijim:

a) Dëshmitari Sh.Z.:

27. Dëshmitari Z. ka dëshmuar⁹ në Gjykatë se atij i është kërkuar që t'i bashkëngjitet projektit nga Z.B., i cili e ka njoftuar I.M. n dhe B.K. me atë. Ai e ka përshkruar se I.M. ka pasur idenë fillestare që të katërtit do të themelonin një grup për të fituar tenderin në valën e 34-të të privatizimit. Është vendosur që B.K.do të regjistrohej në AKP për të përpiluar ofertën, pasi që ai do të mund të nxirrte certifikatën e duhur nga gjykata, përderisa nga A.J. është kërkuar që t'i bashkëngjitet grupit, pasi që ai do të mund të paguante pagesën e regjistrimit. Dëshmitari tregoi se ai ishte përgjegjës për plotësimin e formularëve dhe për të vendosur mbi çmimin. Ai ka theksuar që së bashku me Z.B. ai do të vendoste se gjatë kohës para se të përpilohej ai do të vendoste vet se çfarë çmimi të vendoste në proces. Dëshmitari jepi llogari më tej se gjatë kohës para se të bëhej oferta, ai është takuar me B.D. në Restorantin Memento në Prishtinë, ku ata kanë filluar të flasin për projektet e tyre aktuale. Kur ai e përmendi tenderin, B.D. i ka thënë atij *"Unë e kam një shok, ai do ta kryen punën"*. Një apo dy ditë më vonë D. e ka sjellur H.T. n edhe në një takim. Të dy kanë ofruar për të përfunduar *"punën"* dhe i kanë thënë dëshmitarit për të paraqitur një ofertë prej 2.300.000 Euro. Dëshmitari ka theksuar se përveç që i ka dhënë atij këshillë, të cilën nuk e dëgjuar, ai ishte i pavetëdijshëm se a kanë bërë diçka të pandehurit për ta ndihmuar grupin për të fituar tenderin. Ai ka treguar se pas 3 apo 4 ditësh më pas dhe posa të pandehurit kanë mësuar se grupi e ka fituar tenderin, të pandehurit kanë thirrë dhe kanë kërkuar shumën e pajtuar prej 200.000 Euro. Grupi bashkërisht ka vendosur për të mbledhur paratë duke shitur një pjesë të tokës. Ai ka dëshmuar se një pjesë i është shitur një personi me emrin G., përderisa ai ka dëshmuar se nuk ka njohuri të saktë për shitjet që i janë bërë pronarit të Kompanisë Jugobella.

28. Dëshmitari ka dëshmuar që së bashku me Z.B. dhe I.M., ai i ka takuar të pandehurit në Restorantin Druri dhe i ka dhënë shumën prej 130.000 Euro të gatshme të pandehurve. Ai e ka

⁹ Shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 30 Tetor 2014 dhe 4 Nëntor 2014.

përshkruar në detaje se të tretë i kanë sjellë të hollat të qese të najlonit dhe i kanë dhënë ato të pandehurve të cilët ishin prezent që të dytë . Ai ka dëshmuar se të pandehurit kanë thënë se shuma ishte e pakompletuar pasi që nuk ishin kombinuar 200.000 Euro, dhe bilanci i parave është paguar pas një jave. Pasi që është pyetur se për çfarë janë dhënë paratë, i pandehuri ka thënë se janë dhënë nën kërcenim. Z. më tej kujton se pak më vonë atij dhe Z.B. i janë kërkuar nga H.T. edhe 600.000 Euro tjera, 300.000 Euro prej secilit. Ai deklaron se është kërcënuar dhe se i ka marrë kërcënimet seriozisht por se ai përsëri ka refuzuar që të paguajë çfarëdo shume, thjesht pasi që ai nuk ka pasur aq shumë para.

29. Dëshmitari është ballafaquar me përgjimet e dy tekst mesazheve të cilat janë dërguar nga numri i dëshmitarit B. në numrin e Z.t dhe prapa më 29 prill 2009 dhe lexon: *“çfarë mund t’i them atij shokut, kur ta shohim në Buqi, respekt” dhe “ti nuk ke nevojë që të bësh asgjë 200 copa puna është e kryer”*.¹⁰ Dëshmitari ka konfirmuar se *“200 copa”* kanë nënkuptuar shumën e parave të cilat i kanë kërkuar dy të pandehurit. Pasi që janë ballafaquar me marrëveshjen në dosjen 1, faqe 164 dëshmitari ka theksuar qartë se *“personat e përmendur të cilët e kanë ndihmuar procesin e tenderimit do të shpërblehen me 300.000 Euro”* ishin dy të pandehurit.

30. Trupi gjykues ka vlerësuar se dëshmia e dëshmitarit ishte në përgjithësi e besueshme. Përderisa ishte e qartë për trupin gjykues se dëshmitari ngurronte që të fliste për çështjen në fjalë dhe në veçanti të fliste në lidhje me përfshirjen e dy të pandehurve, ai ka konfirmuar se faktet kryesore të supozimeve faktike, kryesisht ishte marrëveshja me të pandehurit dhe fakti se të pandehurit kanë pranuar një shumë prej 200.000 Euro. Kur dëshmitari ka dëshmuar në lidhje me këtë, ai ishte koherent dhe ai ka ofruar hollësi, që e bëjnë trupin gjykues për të besuar se ai e ka treguar të vërtetën.

b) Dëshmitari Z.B.

31. Dëshmitari Z.B. ka dëshmuar ¹¹ që ai së bashku me I.M., Sh.Z.- të cilin ai e thërret X.- dhe B.K. kanë paraqitur një ofertë në valën e 34-të të privatizimit të AKP. Ai ka theksuar se iniciativa e parë ka ardhur nga I.M.. Më vonë A.J., një shok i B.K., iu ka bashkangjitur grupit. Së pari dëshmitari ka deklaruar se askush tjetër nuk është përfshirë në tender por njëkohësisht ai ka përmendur se do të takohet me të pandehurit, të cilëve ai iu është referuar si *“shokët e X.”*, në kafenetë në Prishtinë që të diskutojnë në lidhje me tenderin pari se të vendoset më datën 20 maj 2009. Ai ka thënë se ata ishin shokët e X.t, dhe se kryesisht X. do të fliste me ata, kur kanë

¹⁰ Shiko Dosjen 3, faqet 114 dhe 136.

¹¹ Shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 4 Nëntor 2014

biseduar se si ta fitojnë tenderin. Ai ka theksuar se Sh.Z. ishte akteri kryesor gjatë asaj kohe dhe se ai është kujdesur për të gjitha dokumentet. Vetëm pasi që është pyetur përsëri ai ka shpjeguar se para se ta plotësonte ofertën Z. e ka njoftuar atë dhe I.M. me H.T. dhe B.D., me të cilët janë takuar në Restorantin Memento rreth orës një dhe pas një gjysmë muaji ata do t'i paguanin 200.000 Euro të pandehurve, në mënyrë që ata të rekrutonin një person i cili do të sigurohej që ata ta fitojnë tenderin. Ai më tutje shpjegoi se këto para do të paguheshin nga shitja e tokave.

32. B. ka konfirmuar se pasi që është fituar tenderi, 10ha tokë i janë shitur Jugobellës për një shumë prej afro 300.000 Eurove, dhe se këto para janë numëruar në shtëpinë e tij. Ai theksoi më pas se këto para kanë shkuar direkt në llogari bankare të AKP-së dhe se ai nuk i ka dhënë para askujt. Pasi që është ballafaquar me marrëveshjen e cila përmban paragrafin: "*Pagesa në shumën prej 120.000 Eurove i është paguar x personit si detyrim ndaj tyre përderisa pagesa është kryer nga Z.B., I.M. dhe dëshmitari Sh.Z. (X.)*"¹² ai ka theksuar se ai nuk e ka ditur se çfarë kuptimi ka dhe se nuk e kujton se e ka nënshkruar.
33. Trupi gjykues kishte përshtypjen se dëshmitari nuk dëshironte të fliste për tërë këtë çështje dhe se ai është përpjekur që t'i shmanget përgjigjeve. Ai vazhdimisht i është referuar sëmundjes së tij dhe kujtesës së tij të dobët. Ai është e qartë se është munduar që mos t'i ngarkoj të pandehurit, deri në atë masë sa që e ka mohuar edhe përfshirjen e tyre disa herë pa u pyetur në lidhje me ta. Më tutje ai është përpjekur që të zvogëlon përfshirjen e tij dhe ka insistuar në rolin e tij si viktimë. Përsëri trupi gjykues ka vërejtur se dëshmitari është munduar që mos të jep përgjigje të rrejshme, por të mbetet i paqartë. Prandaj trupi gjykues e ka vlerësuar deklaratën e tij si pjesërisht të besueshme por deklarata e tij përfundimisht nuk ka treguar sasi të rëndësishme të informatave dëshmuese.

c) Dëshmitari I.M.

34. Dëshmitari I.M.¹³ ka theksuar se ai ka dëgjuar për privatizim dhe ka vendos së bashku me shokun e tij të moçëm Z.B. për të marrë pjesë në tender. Pasi që ai dhe B. kishin mungesë të mjeteve financiare, B. e ka njoftuar atë me Sh.Z. n, të cilin ai e ka prezantuar si pronar të kompanisë së ndërtimit dhe B.K.. Atyre ju nevojiteshin më shumë ortakë të cilët do të mblidhnin paratë dhe e kanë shtuar A.J. në grup, i cili është prezantuar nga B.K.. M. ka theksuar se grupi i ka bërë disa marrëveshje gojore dhe janë pajtuar që tenderi do të paraqitej në emër

¹² Shiko Dosjen 1, faqe 168 dhe 169.

¹³ Shiko procesverbalin e shqyrtimit gjyqesor të mbajtur më 11 dhe 12 nëntor 2014.

të B.K.t, dhe tenderi është fituar më pas.

35. Dëshmitari ka mohuar se ka pasur ndonjë dijeni në lidhje me përfshirjen e ndokujt tjetër në procesin e tenderimit. Pasi që është ballafaquar me disa marrëveshje dhe dokumente të cilat janë shqyrtuar gjatë shqyrtimit gjyqësor¹⁴ ai ka dëshmuar se atij nuk i është kujtuar se për çfarë ishin këto dokumente dhe se përmbajtja e marrëveshjeve nuk ka qenë e qartë për atë asnjëherë. Ai ka theksuar se nuk ka pasur ide se kush ishin “x personat”, të cilët ishin përmendur disa herë në dokumente. Ai ka pranuar se jo vetëm që i ka nënshkruar ato por edhe ai ka insistuar se i ka fotokopjuar ato nga origjinalet vetëm për të pasur prova.
36. M. më tej ka dëshmuar se një ditë pasi që e ka fituar tenderin, ai është informuar në telefon se B.K. ka shitur 10 apo 11 ha tokë pronarit të Jugobellës, dhe se ai është ftuar që të shkonte te shtëpia e Z.B. , ku i kanë numëruar disa prej shumës së parave. Pasi që është ballafaquar me video klipin e lartshënuar ai ka pohuar se pasi që i ka numëruar paratë, ai i ka marrë shënimet të cilat korrespondojnë me provat e dokumentuara¹⁵. Ai ka theksuar se pas numërimit të parave është kthyer në shtëpi. Pasi që është pyetur se përse e ka nënshkruar dokumentin ku thotë se ai i ka dorëzuar ato para dikujt¹⁶, ai ka theksuar se është obliguar që të nënshkruaj këtë pasi që përndryshe ai do të përjashtohej nga grupi.
37. Gjatë marrjes në pyetje, dëshmitari është ballafaquar me protokollin e provave nga përgjimet, kryesisht SMS mesazhet të cilat i janë dërguar atij nga një numër në Zvicër më datat 16, 20 dhe 21 prill 2009, të cilat kanë lexuar: *“O selam alekum. Si je , çfarë je duke bërë. A e din se tenderi është shpallur të Hënën, inshallah, urime, pasi që e kam bërë marrëveshjen me ata shokët. Vendi është i yni dhe askush nuk mund të na e marrë. Unë vetëm duhet të shpjegoj në hollësi se për çka po flasim. Të lutem përgatiti paratë pasi që ne duhet të para-kualifikohemi. Shumë respekt. Islami”, “Hej shoki, 91 ha janë tenderuar në këtë valë. Të tjerat do të përfshihen në tenderin e ardhshëm, pasi që kjo është marrëveshja jone me ata shokët. Ne jemi pajtuar që 300 mijë ti jepen atyre paraprakisht dhe 200 mijë më pas. Të tjerat do të tenderohen kur ne të dëshirojmë. Ne do të marrim aq tokë sa do të kemi dëshirë. Nuk ma ndien fare për këtë. Tani janë edhe disa fabrika etj” dhe “Këtyre ditëve ne do të paraqesim këto në letër dhe ata janë duka ma bërë këtë të mirë mua, pasi që ka konkurrencë të madhe për këtë lokacion. I kam treguar A.. Në rregull.”¹⁷ Dëshmitari M. ka theksuar se këto porosi i janë referuar një parcele tjetër të tokës e cila rastësisht i ka numëruar 91 ha gjithashtu.*

¹⁴ Shiko dosjen 1, faqet 164/165, 168/169, 176/177 dhe 178/179.

¹⁵ Shiko dosjen 1, faqe 168/169.

¹⁶ Shiko dosjen 1, faqe 176/177.

¹⁷ Shiko Dosjen 3, faqet 105 dhe 128.

38. Dëshmitari ka theksuar qartë se ai nuk i ka njohur të pandehurit dhe se ai kurrë nuk ka pasur ndonjë kontakt personal me ata. Vetëm pasi që është ri-marrë në pyetje, ai ka pranuar se është takuar me ata për kafe. Pasi që është pyetur për SMS të cilat i janë dërguar nga numri i tij të pandehurit D. më 27 tetor 2009¹⁸ ai ka theksuar se telefoni i tij është përdorur nga të tjerët, edhe ndonëse mesazhi i dërguar nga telefoni i tij të pandehurit D. ishte nënshkruar me *“Me respekt Islami”*.
39. Trupi gjykues e ka shqyrtuar deklaratën e dëshmitarit si të pabesueshme. Dëshmitari është e qartë se ka gënjyer gjatë pothuajse tërë dëshmisë së tij. Ai ngurronte që të fliste në lidhje me rastin në fjalë dhe me dy të pandehurit. Ai insistonte se nuk i njihte të pandehurit dhe se nuk kishte hyrë në asnjë marrëveshje me ata. Gjatë dhënies së dëshmisë së tij, dëshmitari ishte i paqartë dhe është munduar që mos t'i përgjigjet asnjë pyetjeje apo të tregonte se nuk e ka kuptuar pyetjen. Trupi gjykues e ka marrë parasysh se dëshmitari ishte një person i arsimuar mirë dhe sipas mendimit të trupit gjykues ai ishte në gjendje të kuptonte pyetjet dhe t'i përgjigjej atyre në mënyrë të duhur. Për këtë arsye, trupi gjykues e ka vlerësuar këtë si plotësisht të pabesueshme që dëshmitari i ka nënshkruar disa dokumente me marrëveshje të cilat kanë përfshirë shuma të mëdha parash pa i kuptuar ato fare apo pa u pajtuar në lidhje me to. Dëshmitari edhe e pranuar se ishte ai i cili i ka përpiluar dokumentet të cilat më pas janë nënshkruar nga të gjitha palët prezentë. Më tej, dëshmitari ka gënjyer kur ka theksuar se SMS mesazhet e tij i janë referuar një tjetër ngastre prej 91 ha. Dhe ai e ka dhënë një deklaratë të rrejshme kur e ka mohuar se ka pasur kontakte me të pandehurin D..

d) Dëshmitari A.J.:

40. Dëshmitari A.J. ka theksuar ¹⁹ se atij i është ofruar , një kohë më parë, para se të paraqitej oferta, shoku i tij i familjes B.K., i cili është përcjellë nga I.M.. Këta të dy i kanë treguar atij në lidhje me projektin dhe i kanë ofruar një mundësi që të merr pjesë në grup, nëse ai do të siguronte shumën e regjistrimit prej 25.000 Eurove, të cilën grupi nuk ka mundur ta mbledh. Dëshmitari ka vendosur që të merr pjesë dhe i ka paguar paratë, megjithatë ai nuk ka mundur ta paraqet ofertën e tij zyrtarisht pasi që ishte nën hetime. Prandaj edhe oferta është paraqitur nën emrin e B.K.
41. J. i ka treguar se pasi që është fituar tenderi, dy të pandehurit kanë kërkuar paratë nga grupi. Ai dëshmon se fillimisht është informuar në lidhje me këtë nga B.K. dhe I.M., të cilët kanë ardhur

¹⁸ Shiko Dosjen 3, faqet 107 dhe 130.

¹⁹ See minutes of the main trial held on 26 November 2014.

në zyrën e përbashkët dhe kanë thënë se grupi ka hasur në një problem. Dëshmitari ka theksuar se kjo ishte një tronditje për të, pasi që ai kurrë nuk kishte dëgjuar për përfshirjen e të tjerëve më herët. Të tjerët i kishin thënë se të dy personat, në mesin e tyre H.T., ka kërkuar 300.000 Euro pasi që ata gjoja sikur e kanë bërë tenderin që të arrin sukses. Ai më pas ka kuptuar se grupi e ka mashtruar dhe ka kërkuar që t'i kthehen paratë dhe të tërhiqet nga grupi sa ma shpejtë që është e mundur.

42. Dëshmitari ka dëshmuar me dijeninë e tij se shuma prej 200.000 Eurove i është paguar të pandehurve me dy këste (f.6). A ka shpjeguar se B.K. ka shitur 10 ha tokë L.B., pronarit të Kompanisë Jugobella, për të mbledhur paratë të cilat janë numëruar nga grupi dhe i janë dhënë H.T.t dhe "tjetrit". Me këtë rast atij i është thënë nga B.K., Sh.Z. dhe I.M., se dy të pandehurit e kanë kërcënuar Z.B.. Z.B. ishte në telefon gjatë shumicës së kohës dhe i ka thënë grupit se ai do të bisedon me H.T., i cili do t'i thoshte atij që të ngutet. Ai ka shpjeguar në hollësi se pas numërimit të parave, paratë janë vendosur në qese të najlonit të zeza dhe një grup prej tre personave kanë shkuar të takohen me H.T. Ai ka dashur që t'i bashkëngjitet grupit në mënyrë që të shoh se ku do të dorëzoheshin paratë, por B.K. kishte thënë shprehimisht se ai nuk mund të bashkëngjitej.

43. Trupi gjykues e ka vlerësuar se deklarata e dëshmitarit është pjesërisht e besueshme. Përderisa dëshmitari ka shpjeguar disa prej rrethanave të rastit në një mënyrë koherente, të detajuar dhe përfundimisht në mënyrë të besueshme, ka mbetur e paqartë nëse dëshmitari ka qenë me të vërtetë i panjohur paraprakisht me marrëveshjen. Pasi që dëshmia e tij në lidhje me këtë është konfirmuar me provat e dokumentuara, të cilat tregojnë se ai me të vërtetë e ka lëshuar grupin shumë herët, e bën trupin gjykues të mendoj se është e mundur që ai nuk ishte i vetëdijshëm për marrëveshjet, e cila e bën deklaratën e tij edhe më të besueshme.

e) Dëshmitari H.K.:

44. Dëshmitari K. ka dëshmuar në gjykatë se në shtator 2009 ai është kontaktuar nga dëshmitari B.K., i cili i ka ofruar atij mundësinë që të bëhet partner në të ashtuquajturin projektin e pronave. Ai ishte skeptik në lidhje me projektin dhe e ka diskutuar me familjen e tij, por pas një muaji e ka pranuar ofertën. Përderisa I.M. ka qenë partner në projekt në shtator, K. e ka informuar më vonë atë se M. është tërhequr. Dëshmitari ka theksuar se ai e njihte të pandehurin D. që nga viti 2000, ndërsa me T. ishte njoftuar në tetor 2009. Ata të dy u bënë partner të projektit, kështu që të katërtit do të kishin aksione prej 25% dhe do të përfitonin barabartë nga shitja e tokës. Përderisa K. kishte paguar 137.000 Euro që të bëhej partner, të pandehurit nuk kishin asnjë obligim. Detyra e tyre ishte të gjenin blerësit për tokë. Më tej

dëshmitari ka theksuar se B.K. i ka thënë atij se dy të pandehurit tashmë kishin pranuar 200.000 Euro.

45. Pas pyetjes për SMS të cilat janë dërguar nga telefoni i tij më 10 maj 2010 *“Përmendi ato 200 mijë të parave të L. që ata i morën”*²⁰, që është dërguar nga numri i tij, dëshmitari ka thënë se ai nuk dinte asgjë në lidhje me këto mesazhe dhe se mund të ishin dërguar nga B.K., i cili gjoja sikur e kishte përdorë telefonin e tij. Pas pyetjes me përgjimet e muajit prill 2010²¹ të cilat ndërlidhen me takimet me drejtorin e AKP dhe nënshkrimin e “Kategorisë C” dëshmitari ka mohuar se ka pasur dijeni dhe se nuk i kujtoheshin këto mesazhe.

46. Trupi gjykues e ka vlerësuar deklaratën e dëshmitarit si pjesërisht të besueshme. Përderisa deklarata e dëshmitarit ishte koherente në lidhje me zhvillimin e projektit të pronave pas shtatorit 2009, trupi gjykues vazhdon të ketë dyshime reale në lidhje me përshkrimin e tij të përfshirjes së tij të mëhershme. Është e qarte se dëshmitari ka dashur të zvogëlon përfshirjen e tij apo dijeninë në lidhje me ndonjë aktivitet të paligjshëm. Në lidhje me këtë, gjykata vlerëson se pohimet e dëshmitarit se dikush tjetër e ka përdorë telefonin e tij nuk janë të besueshme.

f) Dëshmitari B.K.

47. Dëshmitari B.K. ka theksuar se ai ishte udhëheqësi kryesor i projektit për të dorëzuar ofertën për 91 ha tokë. Ai dëshmoi se ai ka kërkuar ndihmë prej dëshmitarëve tjerë vetëm kur është ballafaquar me probleme për mbledhjen e parave të cilat i nevojiteshin për ta paguar AKP. Kur është pyetur për pjesë të ndryshme të provave të dokumentuara, ai ka theksuar se dëshmitarët e tjerë kanë ushtruar presion në atë për të nënshkruar dokumentet e përmendura dhe se ai e ka bërë këtë pa i lexuar fare ato. Më tej ai ka theksuar se dëshmitarët Z., B. dhe M. e kanë shantazhuar atë dhe se ata kanë huazuar para prej tij pa ia kthyer ato prapa. Ai më pas ka dëshmuar se dëshmitari H.K. e ka vënë në kontakt me të pandehurit, të cilët i ka pranuar si partnerë afaristë, pasi që ta kanë premtuar se do të gjenin blerës për parcela të tokës.

48. Trupi gjykues e ka vlerësuar dëshminë eK.t si të pabesueshme. Deklarata e dëshmitarit është shumë kontradiktore. K. është munduar të bindë gjykatën se ai ishte kryesisht përgjegjës për tërë procesin dhe vetëm ka kërkuar nga të katër dëshmitarët tjerë ndihmë pasi që ka pasur probleme për ta paguar AKP; sipas mendimit të trupit gjykues dëshmia e tij është e pabesueshme, jo vetëm sepse të gjithë dëshmitarët e tjerë kanë dëshmuar tërësisht diçka

²⁰ Shiko Dosjen 3, faqe 35.

²¹ Shiko mesazhet e ndryshme të dërguara në mars, prill dhe maj 2010, Dosja 3, faqe 34 dhe 35.

tjetër, por edhe pasi që ka prova të besueshme në formë të marrëveshjeve dhe përgjime të cilat tregojnë përfshirjen e tërë grupit që nga fillimi. Më tej është plotësisht e pabesueshme që K. ishte nën presion dhe se i ka nënshkruar dokumentet pa e ditë përmbajtjen e tyre. E tërë rrjedha e ngjarjeve dëshmon se ai ishte në krye të procesit, prandaj është e pabesueshme që dëshmitarët tjerë ishin në gjendje që të detyronin atë. Përveç kësaj, nuk është e besueshme që një person i arsimuar si K. do të nënshkruante diçka të tillë, pa e lexuar fare apo pa u interesuar fare për atë, siç ka deklaruar.

49. Sa i përket asaj që dëshmitari e ka deklaruar se ai i ka huazuar para Sh.Z. të cilat ai nuk i ka kthyer, provat tjera në shkresat e lëndës e dëshmojnë të kundërtën. Në bazë të të dhënave financiare, në fakt babai i Sh.Z. i ka paguar 100.000 Euro në llogari të K.²² Në lidhje me kontratën me të pandehurit, nuk është e besueshme që i pandehuri do të pranonte ato si aksionar i barabartë, vetëm sepse ata kanë ofruar që të gjejnë blerës për tokë. Si dhe ky aktivitet nuk ka mundur të shpjegoj se përse dëshmitari i ka paguar së paku 100.000 Euro secilit prej të pandehurve.

50. Krasniqi e ka mohuar se i ka shitur tokë L.B. në maj apo qershor 2009. Pas pyetjes në lidhje me marrëveshjet në fjalë²³ ai i ka thënë Gjykatës se ai vetëm kishte një marrëveshje për të huazuar para nga B., i cili ishte një mik i familjes dhe se ai nuk i kishte shitur tokë. Edhe kjo përsëri është e pabesueshme, pasi që është në kundërshtim me të gjitha ato që kanë deklaruar dëshmitarët e tjerë dhe se është në kundërshtim me dokumentet e paraqitura si prova. Megjithatë nuk është e diskutueshme që kontrata është realizuar në formë të kontratës për huamarrje, e cila ishte e natyrshme në këtë fazë, pasi që grupi në këtë pikë ishte shumë larg nga të qenurit pronar të ligjshëm të tokës.

51. Krasniqi ka konfirmuar se ai ishte prezent kur u numëruan një pjesë e parave të cilat janë pranuar në të gatshme nga B.. Ai ka deklaruar se këto para janë huazuar nga Z.B., i cili kishte probleme me pagimin e apartamentit në të cilin jetonte. Edhe kjo përsëri është e pabesueshme dhe se dëshmitari nuk ka mundur fare të shpjegon se përse do të huazonte këtë sasi të madhe të parave nga një mik i familjes, apo t'ia jepte një personi të cilin ai nuk e njihnte fare në atë kohë.

²² Shiko dosjen 1, faqe 183.

²³ Shiko Dosjen 1, faqet 186 deri në 189.

III. Analizat e provave në lidhje me elementet e veprës penale

52. Gjykata e bazon konkluzionin e saj në lidhje me elementet e veprës penale në veçanti duke u bazuar në provat në vijim:

a) Zhvillimi i përgjithshëm i procesit të tenderimit dhe grupi ofertues

53. Të dhënat faktike në lidhje me themelimin e grupit ofertues dhe në lidhje me zhvillimin e përgjithshëm të procesit të ofertimit janë bazuar në deklaratat e dëshmitarëve si dhe në provat e dokumentuara. Përderisa të dhënat e hollësishme në lidhje me procesin e tenderimit janë të përmbajtura në provat e dokumentuara të shkresave të lëndës²⁴, zhvillimi i grupit është shpjeguar në hollësi nga dëshmitarët. Sa i përket themelimit të grupit, deklaratat e dëshmitarëve në përgjithësi ishin në harmoni. I vetmi version që nuk përshtatej ishte ai i dëshmitarit K.; trupi gjykues ka gjetur se versioni i tij nuk ishte i besueshëm për arsyet e sqaruara më lartë.

b) Marrëveshja në mes të pandehurve dhe grupit ofertues

54. Dyshimet faktike në lidhje me marrëveshjen në mes të pandehurve dhe grupit ofertues janë bazuar në prova të dokumentuara si dhe në deklaratat e dëshmitarëve dhe në rezultatet e përgjimeve të ligjshme të komunikimeve me telefon dhe tekst mesazheve.

55. Dëshmitari Z., deklaratën e së cilit Gjykata e ka vlerësuar si më të besueshme, të shpjeguar në hollësi se si të dy të pandehurit janë përfshirë në proces. Ai ka përkujtuar se si është takuar së pari me B.D. pastaj me H.T., dhe ai ka siguruar të dhëna në lidhje me rrethanat e takimeve. Ai nuk ka deklaruar se çfarë është dashur të bëjnë saktësisht të pandehurit, por ai ishte i qartë në lidhje me faktet të cilat ata i kanë ofruar për të ndikuar në vendimmarrje të APK për “të përfunduar punën e pronave” dhe ata kanë kërkuar të shpërblehen me 200.000 Euro. Zhvillimet në fazën e hershme janë konfirmuar nga dëshmitari B., i cili ka siguruar detaje të konfirmuara në lidhje me takimet e para me të pandehurit. Përderisa dëshmitari J. i ka theksuar se nuk e ka ditur për marrëveshjen vet, ai ishte i qartë shumë se të tjerët dëshmitarë i kishin treguar në lidhje me marrëveshjen me këta dy të pandehur. Edhe i pandehuri M., i cili ishte shumë ngurrues për të folur në lidhje me të pandehurit e përfshirë, përfundimisht ka theksuar se ka pasur takime me ata në disa kafene në Prishtinë para se të fitohej tenderi.

²⁴ Shiko Dosjen 1, faqet 1 deri në 163.

56. Trupi gjykues i konsideron si prova të besueshme dokumentet e ndryshme të cilat janë shqyrtuar disa herë gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor. Vlerësohet se edhe ndonëse disa prej dëshmitarëve kanë dëshmuar që mos ta kujtojnë përmbajtjen e marrëveshjeve ose ti kishin nënshkruar ato pa e lexuar apo kuptuar përmbajtjen e tyre, origjinaliteti i dokumenteve nuk është sfiduar thellësisht. Duke mos i marrë parasysh disa mospërputhje të vogla, të gjitha marrëveshjet në dispozicion të vendosura së bashku tregojnë një sekuençë logjike dhe kronologjike të ngjarjeve, të cilat i përkrahin faktet e përcaktuara. Nga dokumentet që grupi i ka pasur, rrjedh shumë qartë se grupi ka pasur detyrim që të paguajë së paku 200.000 Euro, të cilat kanë rrjedh nga një marrëveshje e cila është bërë para se të dorëzohej oferta dhe se kjo shumë do të duhej të paguhej në lidhje me ndikimin në APK në procesin e tenderimit.
57. Ky detyrim për të paguar një shumë prej 300.000 Euro *“personave të cilët e kanë ndihmuar procesin e tenderimit”* së pari përmendet në një marrëveshje të brendshme të nënshkruar nga I.M., Z.B., A.J., B.K. dhe Sh.Z.²⁵. Një tjetër dokument i brendshëm i grupit ofertues thekson se *“duke u bazuar në marrëveshjen e 12 majit 2009 (...)Pagesa e shumës prej 120.000 Euro i është bërë personave x si një detyrim për ata përderisa pagesa është bërë nga Z.B., I.M. dhe dëshmitari Sh.Z. (X.)”*²⁶. Ky dokument është shkruar nga I.M. dhe është nënshkruar nga B., M., J. i dhe K., dhe nga Z. dhe Veli J. i si *“dëshmitarë”*.
58. Fakti se grupi i dëshmitarëve ka hyrë në një marrëveshje me dikën i cili do t'i ndihmonte ata që të fitojnë tenderin është konfirmuar gjithashtu nga rezultatet e përgjimeve të ligjshme. Mesazhet e dërguara nga dëshmitari I.M. më 16, 20 dhe 21 prill 2009 tregojnë qartë se dëshmitari ishte mjaft i bindur që grupi do të shpërblehej me tender dhe se ishte i përfshirë edhe një lloj i marrëveshjes²⁷. Dhe në shkëmbimin e SMS-ve në mes të Z. dhe B. të datës 29 prill 2009²⁸ Z. ka shkruar : *“ti nuk ke nevojë me bërë asgjë, 200 copa dhe puna është duke u kryer ”*. Në shqyrtimin gjyqësor, dëshmitari ka konfirmuar se 200 copa ishin 200.000 Euro të cilat do t'i paguheshin të pandehurve.
59. Pas shqyrtimit të provave të pranueshme, trupi gjykues vjen deri në përfundimin e bindshëm se personat me të cilët është arritur marrëveshja ishin në të vërtetë dy të pandehurit. Kjo nuk është konfirmuar vetëm shprehimisht nga dëshmitarët Z., B. dhe J. i, është gjithashtu edhe një shpjegim logjik se përse kjo shumë e saktë i ishte paguar përfundimisht të pandehurve (shiko më poshtë). Sa i përket faktit se në marrëveshjet me shkrim emrat e të pandehurve nuk ishin

²⁵ Shiko Dosjen 1, faqet 164 dhe 165.

²⁶ Shiko Dosjen 1, faqe 168 dhe 169.

²⁷ Siç është cituar më lartë, shiko Dosjen 3, faqet 105 dhe 128

²⁸ Shiko Dosjen 3, faqet 114 dhe 136.

përmendur, një sqarim i mundshëm duket të jetë se anëtarët e grupit kanë qenë të vetëdijshëm në lidhje me natyrën ilegale të kësaj marrëveshjeje. Është më shumë e mundshme se ata i janë referuar “personave x” sepse ata kanë besuar se destinacioni final i pjesës më të madhe të parave do ishin personat e tjerë identitetin e të cilëve ata nuk e kanë ditur.

c) Pranimi i 200.000 Eurove si kompensim

60. Trupi gjykues është i bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se që të dy të pandehurit e kanë pranuar shumën prej 200.000 Eurosh si kompensim i premtimit për të ndikuar në vendimmarrjen e AKP-së. Kjo bindje është e bazuar në deklaratat e dëshmitarëve, dëshmitë e dokumentuara, videon e cila ishte ekzaminuar në shqyrtimin kryesor, të dhënat financiare dhe rezultatet e përgjimeve të ligjshme gjatë hetimeve.
61. Në video klipin i cili ishte bërë nga A.J.²⁹ shfaqet se në një ditë të caktuar në muajin Maj të vitit 2009, dëshmitarët qenë bashkuar për të numëruar një sasi të madhe të parave të gatshme. Të gjithë dëshmitarët që janë parë në atë video dhe që ishin konfrontuar me këtë, përpos B.K., kanë konfirmuar se kjo shumë e parave, pak më parë, ishte pranuar nga dikush i cili e kishte dhënë si kompensim për tokën para shitjes. Dëshmitarët B., J. i dhe M. e kanë përmendur L.B. n, pronarin e Jugobellës. Dëshmitarët Z. dhe J. i kanë konfirmuar shprehimisht se këto para ishin numëruar në mënyrë që tu jepeshin dy të pandehurve. Dëshmitari Z. ka përshkruar në detaje se si janë numëruar paratë dhe pastaj janë futur në një qese dhe u janë dorëzuar të pandehurve nga ai dhe B.. Dëshmitari J. i ka theksuar se ai nuk ka qenë i vetëdijshëm në lidhje me ndonjë marrëveshje më parë por ai ka konfirmuar se të pandehurit kanë kërkuar një sasi parash sepse supozohet se ata i kanë ndihmuar grupit që ta fitojnë tenderin. Ai e ka përshkruar se si gjatë numërimit dëshmitarët Z. dhe B. kanë qenë në kontakt me të pandehurit.
62. Trupi gjykues më tej ka marrë në konsideratë dokumentet e ndryshme që janë ekzaminuar gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor të cilat në mënyrë të qartë lënë që të kuptohet se një sasi e parave ishte paguar si obligim për një marrëveshje të mëparshme. Një marrëveshje e brendshme e shkruar nga M. dhe e nënshkruar nga M.,K., B. dhe J. i thekson: “ 100.000 euro janë shpenzuar si një pagesë e obligimeve ndaj personave x dhe transferi ishte bërë nga Z.B., I.M. dhe Sh.Z. (...).³⁰ Në mënyrë të njëjtë llogaritja që është në provat e dokumentuara përmban nën “ shpenzimet” pjesën “ Shpërblimet për x personat = 300.000 euro”.³¹ Trupi gjykues ka marrë në konsideratë se shumica e gjësendeve të gjetura në atë llogaritje përputhet me

²⁹ Shih dosjen 1 të transkripteve, faqe 206.

³⁰ Shih dosjen 1, faqet 176 dhe 177.

³¹ Shih dosjen 1, faqet 178 dhe 179

transaksionet e përcaktuara financiare.

63. Ashtu siç pretendon aktakuza se rata e parë prej 160.000 Euro ishte paguar, kjo informatë nuk është vërtetuar me informacionin që është pranuar përmes dëshmime të pranueshme. Dokumentet përmendin shuma të ndryshme në mes të 120.000 dhe 130.000 euro. Të gjithë dëshmitarët i janë referuar kohës së gjatë që ka kaluar që atëherë dhe kanë deklaruar të jenë jo aq të sigurve në lidhje me shumën e saktë. Nga marrëveshja e brendshme në dëshmitë e dokumentuara³², duket që ka shumë të ngjarë se shuma që ishte numëruar dhe dorëzuar në po atë ditë, ka qenë mes 120.000 dhe 130.000 Euro.
64. Sidoqoftë, pavarësisht nga shuma e saktë që ishte paguar në ratën e parë, gjykata është e bindur se në fakt rata e dytë që bërë jo shumë pas kësaj ashtu që totali prej 200.000 Eurove që paguar. Dëshmitarët Z. dhe J. i shprehimisht kanë deklaruar se kjo shumë ishte paguar në dy rata. Pagesa e shumës totale është konfirmuar më tej nga H.K. deklarata e të cilit në këtë pikëpamje është e besueshme meqë ai nuk ka qenë i përfshirë në ato ngjarje. Deklarata e tij është mbështetur nga element i mëtejme i dëshmisë. Në mesazhin tekstual me datë 10 Maj 2010 ai ka shkruar “ *Përmendi ato 200 mijë të parave të Lulit që ata i kanë marrë*”³³ që e bën të qartë se një shumë prej 200.000 eurosh që paguar në të vërtetë³⁴.
65. Trupi gjykues më tej është i bindur se këto para janë ngritur nga para-shitja e tokës. Ky fakt që konfirmuar nga dëshmitarët Z., B., M. dhe J. i dhe është mbështetur nga dëshmi të dokumentuara, d.m.th. kontrata mbi huamarrjen në para të gatshme me L.B. dhe kontrata e para-shitjes³⁵ si dhe nga të dhënat financiare. Ekzaminimi i xhirollogarisë bankare të B.K.t tregon se ai e ka pranuar një shumë parash pasi që marrëveshja me L.B. n që finalizuar, gjersa në pjesë e parave që paguar në para të gatshme. Prandaj, nuk ka dyshim se në fakt grupi ka pasur mjaft para për ta paguar shumën në fjalë.
66. Gjkata është e bindur se këto para janë paguar si një obligim në drejtim pandehurve sipas marrëveshjes së mëparshme. Në lidhje me atë se çfarë tha dëshmitari Z. se paratë qenë dhënë nën kërcënim kjo nuk është vërtetuar nga ndonjë deklaratë tjetër, nuk përputhet me dëshmitë e dokumentuara dhe andaj janë jo të besueshme. Këto pjesë të dëshmimeve tregojnë se shuma në fakt që paguar si kompensim për “ndihmë” në lidhje me tenderin. Kjo është më tej e

³² Shih dosjen 1, faqet 168 dhe 169

³³ Shih dosjen 3, faqe 35

³⁴ Për aq sa ka dëshmi d.m.th. në formë të dokumenteve f. 178/179 të dosjes 1, se të pandehurit në fakt kanë pranuar më shumë se 200.000 euro, një shumë deri në 300.000 euro, paneli ka vlerësuar se kjo nuk është vërtetuar sepse nuk që mbështetur nga ndonjë dëshmi tjetër

³⁵ Shih dosjen 1, faqet 170 e deri në 175

mbështetur nga video incizimi , i cili tregon dëshmitarët të jenë në disponim të mirë, e që duket të jetë e arsyeshme sepse ata ishin para mbylljes së një marrëveshjeje dhe jo nën një kërcënim serioz.

d) Zhvillimet e mëtejme të projektit të tokës

67. Përfundimi i Gjykatës në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të grupit të projektit dhe përfshirjen e të pandehurve është e bazuar në dëshmi të dokumentuara, në rezultatet e përgjimeve, të dhënat financiare dhe deklaratën e dëshmitarit K.
68. Dokumentet të cilat janë në dispozicion në dosjen e rastit ³⁶ tregojnë se nga shtatori i vitit 2009 mbi të pandehurit kanë qenë aksionarët në grupin e projektit, të cilët nga muaji tetor 2009 janë përbërë nga të pandehurit K. dhe K. gjersa më vonë persona tjerë ishin të përfshirë si dhe drejtorët e NewCo toka bujqësore M. 2009 SHPK. Xhirollogaritë bankare të B.K.t ³⁷ tregojnë se të pandehurit kanë marrë së paku nga 40.000 euro secili dhe dëshmitari K. në deklaratën e tij ka vlerësuar se që të dy të pandehurit kanë bërë një profit prej rreth 100.000 eurosh. Gjersa trupi gjykues nuk është bindur nga deklarata e K. fare, xhirollogaria bankare dhe dokumentet tregojnë se të pandehurit kanë qenë aksionarë të projektit dhe se ata kanë pranuar shuma të mëdha. Provat e dokumentuara tregojnë shumë qartë se departamentet përkatëse në AKP, në mes të muajit Mars dhe Prill 2010 kanë diskutuar se si të vazhdohet me privatizimin e tokës³⁸ pasi që e gjithë shuma e ofertuar ishte paguar por një masë e përkohshme për një pjesë të tokës ka qenë ende në fuqi.
69. Protokollin e përgjimeve të ligjshme të komunikimeve tregon se gjatë kësaj kohe, me datë 15 Mars 2010, dëshmitarët K. si dhe i pandehuri Th., nofka e mirënjohur e të cilit është R., kanë qenë në kontakt me punëtorët e AKP-së dhe me siguri kanë ushtruar ndikim tek drejtori i saj D.A.. Në një mesazh tekstual³⁹ K. i ka shkruar K. *“hej xhaxha do të ishte mirë që ti ia jepni ato emra R. dhe tregojani atë kategori C. Atë që ata e kanë nënshkruar.”* Dhe K. ishte përgjigjur: *“ po, unë i kam thënë atij në telefon , ai ka thënë mos u brengos, D. ka thënë se do të shohim nesër”*. Pak kohë më pas, me datë 06 Prill 2010 kontrata që finalizuar në favor të grupit ⁴⁰ , trupi gjykues është i bindur se i pandehuri Th. ka pasur kontakt me zyrtarët përgjegjës të AKP-së të cilët kanë qenë të përfshirë në vendimin e tij.

³⁶ Shih dosjen 1, faqet 191 deri në 196

³⁷ Shih dosjen 1, faqe 183

³⁸ Shih dokumentet në dosjen 1, faqet 145 deri në 162

³⁹ Shih dosjen 3, faqe 35

⁴⁰ Shih marrëveshjet finale dosja 1, faqet 224 deri në 234

F. ARSYETIMI LIGJOR

I. Ligji i aplikueshëm,

70. Ngjarjet e përcaktuara më sipër janë shfaqur në mes të prillit 2009 dhe prillit 2010, kur ligji në fuqi ka qenë i zbatueshëm, ka qenë Kodi Penal i Kosovës që ka hyrë në fuqi me datë 06 Prill 2004 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Ishte ndryshuar me datë 06 Nëntor vetëm duke e ndërruar emrin e tij në Kodi Penal i Kosovës. Sidoqoftë, Kodi i Penal i Kosovës i ri (në tekstin e mëtejme i referuar si “ KPK”, Ligji Nr. 04/L-082) ka hyrë në fuqi me 1 Janar 2013.
71. Trupi gjykues vë në pah se që të dyja edhe ligji i vjetër (KPPK) edhe ligji i ri (KPK) shprehin parimin e përbashkët në ligjin penal: *“Ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të aplikohet ndaj kryesve të veprës”*⁴¹. Sidoqoftë, që të dyja ligjet. Sidoqoftë, që të dyja ligjet po ashtu shprehin përjashtimin e pranuar në përgjithësi : *“ në rast të ndryshimit në ligjin në fuqi tek një rast, para vendimit përfundimtar, do të zbatohet ligji që është më së shumti në favor të të pandehurit”.*
72. Trupi gjykues e ka interpretuar këtë si kërkim në elementet thelbësore të veprës penale por po ashtu edhe niveli dhe kalkulimi i çfarëdo dënimi të lidhur. Është vënë re se elementet thelbësore të Nenit 345 (1) të KPPK-së dhe 431 (1) KPK janë të barabarta, edhe pse përpilimi i dispozitave është pak ndryshe. Dallimi kryesor është se sipas Nenit 345 (1) KPPK Ushtrimi i Ndikimit dënohet me gjobë apo me burgim deri në dy vjet, ndërsa në bazë të Nenit 431 (1) KPK vepra penale dënohet me gjobë apo me burgim deri në 8 vjet. Ligji në fuqi, atëherë, është ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale .

II. Elementet e veprës penale

73. Të pandehurit D. dhe Th. e kanë kryer veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit në bashkë-kryerje sipas Nenit 345 (1) KPPK i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në mes të prillit 2009 dhe prillit 2010 dhe është ligji më i favorshëm në krahasim me rregulloren aktuale.

Neni 345 (1) KPPK përcakton:

74. *Kushdo që kërkon, merr ose pranon një ofertë ose premtim të një përparësie të padrejtë për vete ose për personin tjetër në lidhje me ushtrimin e një ndikimi të pa duhur nga ana e kryerësit mbi vendimarrjen e një personi zyrtar, pavarësisht nëse ndikimi është ushtruar ose pavarësisht*

⁴¹ Neni 2 (1) KPPK dhe Neni 3 (1) KPK

nëse ushtrimi i supozuar shpie deri te rezultati i synuar dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

75. Elementet objektive të veprës penale janë përmbushur. Të pandehurit kanë kërkuar dhe pranuar një paradhënie të parregullt të 200.000 eurove e cila u ishte paguar atyre mbi bazat e marrëveshjes përkatëse nga dëshmitarët Z. dhe B.. Konsiderimi për këtë shumë ka qenë detyrimi i një ndikimi të pa duhur, do me thënë ndikimi mbi një vendim në mënyrë që të aprovohet tenderi ne Valën e 34-të të privatizimit, ofertës e cila ishte bërë në emër të B.K.t.
76. Gjersa procedurat e provave nuk kanë bërë të ditur informacion të detajuar mbi atë se si pikërisht ky ndikim do të ishte ushtruar, është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kishin ofruar për të ushtruar ndikim. Paneli pas shqyrtimit me kujdes të dispozitave ligjore të Nenit 345 (1) KPPK vëren, se fokusi i kësaj vepre penale është zhvendosur nga ndikimi aktual i një vendimmarrje në një fazë të mëhershme. Në këtë drejtim është vënë në pah, se për elementet objektive të veprës penale, ushtrimi i ndikimit nuk është i nevojshëm. Premtimi i thjeshtë për të ushtruar ndikim në shkëmbim të një avantazhi të padrejtë është sjellja që përbën përgjegjësi penale. Prandaj mungesa e njohurive konkrete të rrethanave të ushtrimit të ndikimit, dhe veçanërisht e personit të caktuar në të cilin ndikimi është për t'u ushtruar është jo material, për aq kohë sa ajo është provuar se ka pasur një ofertë serioze për të ushtruar ndikim të tillë.
77. Trupi gjykues nuk ka dyshim se në çështjen në fjalë, oferta e të pandehurve për të ushtruar ndikim në marrjen e vendimeve në lidhje me tenderin, ishte një ofertë serioze. Më tej, është konsideruar nga Gjykata se ka shumë gjasa se një lloj i ndikimit të vërtetë ishte ushtruar gjatë vendimit për dhënien e tenderit; dhe kjo është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit kanë ushtruar ndikim në vendimin për të finalizuar procesin e privatizimit në prill të vitit 2010.
78. Ndikimi në fjalë ishte drejtuar në vendimmarrjen e personit zyrtar. Në bazë të Nenit 107 (1,3) KPPK një personi zyrtar është një person i cili ushtron detyra të posaçme zyrtare në bazë të autorizimit të dhënë me ligj. Natyrisht në kuptimin e Nenit 345 (1) KPPK ndikimi duhet të ketë për qëllim një vendim-marrje në fushëveprimin e këtij autorizimi. Ky është rasti këtu. Agjencia Kosovare e Privatizimit është një entitet publik, punonjësit e saj kryejnë detyrat zyrtare, në bazë të një autorizimi të paraparë me ligj. Influenca ishte drejtuar drejt vendimit për dhënien e një tenderi, për ekzekutimin e të cilit nëpunësit civilë përkatës janë të autorizuar me ligj.
79. Siç është përmendur në seksionin e pretendimeve faktike, dy të pandehurit kryesisht kanë

vepruar së bashku, prandaj sjellja e tyre duhet që të klasifikohet si bashkëkryerje sipas Nenit 23 KPPK.

80. Elementet subjektive të veprës penale janë plotësuar gjithashtu. Sipas Nenit 15 KPPK një person vepron me dashje direkte kur ai ose ajo është i vetëdijshëm për veprën e vet dhe e dëshiron kryerjen e saj. Të pandehurit D. dhe Th. kanë dëshiruar për të marrë një paradhënie të padrejtë për ndikimin e ofruar, dhe ata ishin të vetëdijshëm se ky ndikim ishte i pavend dhe në shënjestër kishte vendimmarrjen e personit zyrtar. Më tej, ata ishin të vetëdijshëm se ata kanë vepruar në bashkëpunim, dhe kanë dëshiruar për ta bërë këtë.

G. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

I. Ligji i aplikueshëm

81. Trupi gjykues i referohet vlerësimit të bërë më sipër dhe vë në pah se ligji në fuqi në lidhje me dënimin është neni 345 (1) KPPK, meqë ka qenë ligji në fuqi në kohën kur vepra penale është kryer dhe në krahasim me ligjin që është në fuqi tani është me i favorshëm (*lex mitior*)⁴².

II. Rregullat e përgjithshme dhe Qëllimi i Dënimit

82. Sipas Nenit 34 KPPK-së qëllimi i dënimit është (1) për të parandaluar kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe për të rehabilituar kryerësin; dhe (2) të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale. Sipas Nenit 64 KPPK gjykata do të përcaktojë dënimin e veprës penale brenda afateve të parashikuara nga ligji për vepër të tillë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat që janë relevante për zbutjen apo rëndimin e dënimit dhe, në veçanti, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin ose rrezikun apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryerësit, rrethanat personale të kryerësit dhe sjellja tij/e saj pas kryerjes së veprës penale.

III. Kufijtë e dënimit të parashikuara nga ligji

83. Në bazë të Nenit 345 (1) KPPK vepra penale e ushtrimit të ndikimit është e dënueshme me gjobë apo me burgim deri në 2 vjet. Trupi gjykues ka gjetur se nuk ka arsye për të zbutur apo rënduar kufijtë e dënimit të parashikuara me ligj meqë kushtet e dhëna në Nenet 65 deri në 67

⁴² Meqë dallimi thelbësor në mes të vendimit të vjetër dhe të ri është se dënimi maksimal është rritur nga 2 e deri në 8 vjet, Ligji I vjetër penal përmban dispozitën e favorshme jo vetëm në mënyrë abstrakte por edhe në mënyrë konkrete.

nuk janë përmbushur.

IV. Përcaktimi konkret i dënimit për të pandehurin B.D.

84. Në rastin e B.D.t trupi gjykues ka konstatuar një rrethanë të rëndësishme lehtësuese, kjo është periudha e gjatë e cila ka kaluar që nga kryerja e veprës penale. Si një rrethanë rënduese trupi gjykues ka konstatuar se rreziku për të mbrojtur vlerat, funksionimi dhe administrata publike e pavarur, ka qenë relativisht i lartë. Meqë Kosova është një vend në tranzicion, procesi i privatizimit të tokës është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Dëmtim i besimit në vendimet publike në këtë drejtim është duke e dëmtuar seriozisht stabilitetin dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Më tej vërehet se përfitimi material i 200,000 Euro ishte relativisht i lartë, edhe pse trupi gjykues është i vetëdijshëm se kjo shumë mund të ketë qenë e ndarë në mes të personave të ndryshëm. Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit, trupi gjykues konstaton se ai ishte plotësisht përgjegjës, dhe se bashkë-kryerja u realizua me kontributin e barabartë nga të dy të pandehurit. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues-paneli konstatoi sjelljen e të pandehurit para kryerjes së veprës penale, pasi ai asnjëherë nuk u dënua më parë. Rrethanat personale të të pandehurit, i cili është i martuar dhe baba i katër fëmijëve, u konsideruan në favor të tij.
85. Duke matur me kujdes të gjitha rrethanat e përmendura më sipër dhe duke marrë në konsideratë qëllimet e dënimit, si dhe rregullat e përgjithshme për të përcaktuar dënimin, Gjykata shqipton **dënimin me burgim prej 1 viti e 3 muaj.**
86. Pas shqyrtimit me kujdes të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese në këtë rast, trupi gjykues përfundon se dënimi nuk mund të pezullohet në këtë rast. Në pajtim me Nenin 42 KPPK qëllimi i dënimit me kusht është që t'i japë kryerësit një qortim që arrin qëllimin e dënimit përmes shpalljes së dënimit pa e ekzekutuar atë. Gjykata konstatoi se edhe pse një kohë e gjatë ka kaluar që kur është kryer vepra penale; shpallja e thjeshtë e dënimit pa e ekzekutuar atë nuk do të arrijë qëllimin e dënimit. Në këtë aspekt, trupi gjykues vëren se qëllimi i dënimit sipas Nenit 34 të KPPK-së nuk është vetëm për të parandaluar kryerësin nga përsëritja e veprave penale, por edhe për të penguar të tjerët nga kryerja e veprave penale, dhe se veprat penale nga kapitulli XXIX, veprat penale kundër detyrës zyrtare janë me interes të veçantë për publikun⁴³. Më tej ajo është e shënuar, siç është përshkruar më lart, që në këtë rast dëmi për vlerën e mbrojtur ishte shumë i lartë, siç ishte edhe paradhënia e marrë e panevojshme e

⁴³ Edhe pse kjo nuk është relevante për rastin në fjalë, vërehet se me Kodin e ri Penal të Kosovës (KPK) ligjvënësi në mënyrë drastike e ka ngritur dënimin maksimal në këtë seksion të Kodit Penal, duke shprehur relevancën e këtyre veprave penale.

200,000 Eurove.

87. Trupi gjykues ka vlerësuar se nuk është proporcionale që të caktohet dënimi plotësues i gjobës kundër të pandehurit.

V. Përcaktimi konkret i dënimit për të pandehurin H.T.

88. Në rastin kundër H.T.t, trupi gjykues ka konstatuar si rrethanë të rëndësishme lehtësuese periudhën e gjatë kohore e cila ka kaluar që nga kryerja e veprës penale. Si një rrethanë rënduese trupi gjykues ka konstatuar se rreziku për t'i mbrojtur vlerat, funksionimin dhe pavarësinë e administratës publike, ka qenë relativisht i lartë. Meqë Kosova është një vend në tranzicion, procesi i privatizimit të tokës është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e vendit. Dëmtim i besimit në vendimet publike në këtë drejtim është duke e dëmtuar seriozisht stabilitetin dhe duke ndikuar negativisht në zhvillimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Më tej vërehet se përfitimi material i 200,000 Euro ishte relativisht e lartë, edhe pse trupi gjykues është i vetëdijshëm se kjo shumë mund të ketë qenë e ndarë në mes të personave të ndryshëm. Në lidhje me përgjegjësinë penale të të pandehurit trupi gjykues konstaton se ai ishte plotësisht përgjegjës, dhe se bashkë-kryerja u realizua me kontributin e barabartë nga të dy të pandehurit. Si rrethanë lehtësuese trupi gjykues-paneli konstatoi rrethanat personale të të pandehurit, i cili është i martuar dhe baba i dy fëmijëve .

89. Trupi gjykues ka konsideruar dënimin e mëparshëm të të pandehurit, i cili u dënua me një dënim të përgjithshëm prej dy vitesh për veprat penale të tentim vrasjes së rëndë dhe blerje të paautorizuar, posedim dhe përdorim të armëve, nga ana e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 12 Mars 2009. Ky vendim u apelua dhe tërësisht konfirmohet nga një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 9 Shkurt 2011.

90. Paneli konsideron se i pandehuri nuk ishte për t'u konsideruar një përsëritës në një mënyrë formale, sepse në kohën e kryerjes së veprës penale në periudhën kohore të mëposhtme prill 2009, ai nuk është dënuar me vendim të formës së prerë. Megjithatë, duke pasur parasysh sjelljen e tij të mëparshme është dashur që të merret parasysh se në këtë kohë i pandehuri tashmë i kishte kaluar katër muaj në burg dhe ka qenë i vetëdijshëm se hetimet penale dhe procedurat ishin në vazhdim e sipër kundër tij. Por duke e aplikuar parimin e dhënë në Nenin 64 të KPPK-së, trupi gjykues vëren se vepra e mëparshme penale ka qenë thelbësisht e llojit tjetër dhe është kryer për motive të ndryshme. Prandaj, trupi gjykues ka konstatuar se këto procedura penale do të ishin të një rëndësie të vogël dhe jo vendimtare për vendimin në fjalë.

91. Duke i peshuar me kujdes të gjitha rrethanat e dhëna më sipër dhe duke marrë në konsideratë qëllimet e dënimit, si dhe rregullat e përgjithshme për të përcaktuar dënimin, **Gjykata shqipton dënimin me burgim prej 1 viti e 3 muaj.**
92. Trupi gjykues është i vetëdijshëm në lidhje me dispozitën e Nenit 72 të KPP-së. Kjo dispozitë duhet që teorikisht të jetë e zbatueshme këtu për arsye se i pandehuri e ka kryer dënimin pasi që e ka kryer një veprë penale në këtë rast. Si pasojë, një dënim më i rëndë duhej që të ishte caktuar ndaj të pandehurit. Në këtë pikëpamje, trupi gjykues ka marrë në konsideratë se në procedurat e tjera i pandehuri ka qenë në fakt i liruar me kusht pasi që ka mbajtur pak më shumë se një të tretën e dënimit. Ai ka qenë nën mbikëqyrje deri në muajin prill 2013, mbikëqyrja kishte përfunduar sepse ai ka qenë nën hetime të reja. Megjithatë, nuk ka pasur një vendim zyrtar nga Paneli i Lirimeve me Kusht nëse pjesa e suspenduar e dënimit- më shumë se 13 muaj burgim-duhej që të mbahej apo jo. Prandaj, trupi gjykues ka hasur në vështirësi në llogaritjen e dënimit sipas Nenit 72 KPK dhe ka konstatuar se për shkak të rrethanave zbatimi i kësaj rregulle do të ishte jo në avantazh të të pandehurit. Prandaj, në bazë të kësaj, trupi gjykues ka vendosur që të mos e zbatojë nenin 72 të KPK-së.
93. Pas shqyrtimit me kujdes të të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese në këtë rast, trupi gjykues ka konstatuar se dënimi nuk mund të pezullohet në këtë rast. Në bazë të Nenit 42 KPPK, qëllimi i dënimit me kusht është që ti jepet kryesit të veprës një qortim e cila e arrin qëllimin e dënimit duke e shpallur dënimin pa e ekzekutuar atë. Gjykata ka konstatuar se edhe pse ka kaluar një kohë e gjatë qëkur vepra penale ishte kryer, vetëm shpallja e dënimit pa e ekzekutuar atë, nuk do e arrinte qëllimin e dënimit. Në këtë pikëpamje, trupi gjykues vë në dukje se qëllimi i dënimit në bazë të Nenit 34 të KPPK-së nuk është vetëm që ta parandalojë kryesin e veprës penale nga përsëritja e veprës penale, por po ashtu edhe për të penguar të tjerët që të kryejnë vepra penale, dhe veprat penale nga kapitulli XXIX, veprat penale kundër detyrave zyrtare janë të një interesi të posaçëm për publikun e gjerë.⁴⁴Më tej është vënë në pah, ashtu siç është dhënë më sipër, se në këtë rast dëmi për vlerat e mbrojtura ka qenë shumë i lartë, ashtu siç ka qenë pranimi i paradhënies i së paku 200.000 eurove.
94. Trupi gjykues ka konstatuar se nuk është proporcionale që të caktohet një dënim plotësues i gjorbës kundër të pandehurit.

⁴⁴ Edhe pse kjo nuk është me rëndësi, përcaktimi i dënimit konkret në rastin në fjalë, është vënë në dukje se me Kodin e Ri Penal të Kosovës, (KPK) ligjvënësi në mënyrë drastike e ka rritur maksimumin e dënimeve në këtë seksion të kodit penal, duke shprehur rëndësinë e këtyre veprave penale.

H. KONFISKIMI

I. Ligji i aplikueshëm

95. Trupi gjykues vë në pah se rregulloret në lidhje me konfiskimin e aseteve ndryshojnë në sistemin ligjor para vitit 2013 dhe tani. Sipas KPPK-së, ligji material penal në fuqi në atë kohë kur është kryer vepra penale, konfiskimi i të mirave materiale do ishte dhënë nën Nenin 82 dhe 83 të KPPK-së. Sipas atyre rregullave, çdo e mirë materiale e përfituar nga kryerja e një veprë penale do të konfiskohet nga një aktgjykim i gjykatës që do e përcaktojë kryerjen e veprës penale. Sipas Nenit 83 të KPPK-së, kryesi do të jetë i obliguar që ta paguajë shumën e parave që i përgjigjet të mirës materiale të përfituar, kur konfiskimi nuk është i mundshëm. Neni 96 dhe 97 përmbajnë dispozita të ngjashme, gjersa ato i referohen Neneve 276 dhe 284 të KPK-së. Trupi gjykues vlerëson se dispozitat në thelb janë të barabarta; gjersa dallimi i vetëm qëndron në faktin se sipas Nenit 284 (1) KPK vendimi duhet që të lëshohet në formë të një urdhri.

II. Konfiskimi

96. Trupi gjykues vë në pah se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se që të dy të pandehurit në muajin maj të vitit 2009 e kanë pranuar shumën prej 200.000 eurosh me kryerjen e veprës penale të ushtrimit të ndikimit. Prandaj, në mënyrë direkte e kanë pranuar këtë shumë parash e cila duhet që të klasifikohet si e mirë materiale e përfituar nga kryerja e veprës penale. Meqë shënimet përkatëse nuk janë në dispozicion për konfiskim, Gjykata konstaton se obligimi për ta paguar kompensimin në shumën e njëjtë është i aplikueshëm.

97. Trupi gjykues vë në pah se nuk është me rëndësi që të pandehurit kanë mundur që të bëjnë shpërndarjen e një pjesë së këtyre parave, pasi që ata në mënyrë të drejt për drejt i kanë pranuar paratë. Më tej, meqë që të dy të pandehurit kanë vepruar në mënyrë të bashkuar, ata e mbajnë obligimin që ta kthejnë këtë shumë parash në mënyrë solidare.

98. Meqë shuma është relativisht e lartë që do të konfiskohet, është konstatuar si e përshtatshme për trupin gjykues që t'i lejojë të pandehurit që t'i paguajnë këto para në 20 rata dhe në shumën e 10.000 Eurove.

I. SHPENZIMET E PROCEDURËS

99. Të pandehurit **B.D.** dhe **H.T.** secili do e bëjë kompensimin në shumën prej njëqind e pesëdhjetë eurosh (150€) si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale gjersa do të lirohen nga detyrimi

për të kompensuar bilancin e shpenzimeve të procedurës penale, sipas Nenit 453, paragrafët 1, 3 dhe 4 të KPPK-së.

Kryetare e trupit gjykues:

Gjyqtarja e EULEX-it Jennifer
Seel

Procesmbajtës:

Zyrtari Ligjor i EULEX –it David
Hegarty

KËSHILLË LIGJORE:- Të pandehurit, avokatët e tyre mbrojtës, Prokurori apo një palë e dëmtuar i kanë pesëmbëdhjetë ditë (15) nga të shërbyerit e këtij aktgjykimi për të parashtruar ankesë në përputhje me Nenin 380 paragrafi 1 dhe Neni 381 paragrafi 1 i KPK-së. Çdo ankesë duhet që të parashtrohet në Gjykatën e Shkallës së Parë sipas Nenit 388, paragrafi 1 i KPP-së.